Lezhë, më 28.07.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 28.07.2022, në orën 09:00,
në sallën e Qendrës kulturore të fëmijëve (QKF),
mbi mbledhjen e radhës të muajit korrik 2022,
e cila nuk u realizua në datat 26 dhe 27
për mungesë kuorumi.

Mbledhja drejtohet nga zv/kryetari z. Ndue Luli
për shkak të parapritjes së aktit të dorëheqjes
nga z. Ernest Prekaj.

Kryesuesi i mbledhjes z. Ndue Luli hapi
mbledhjen, pas verifikimit të pranisë së
kuorumit dhe lexoi rendin e ditës dhe
dy projekt vendime shtesë.

Fjalën e kërkoi këshilltari z. Hasan Muçe
i cili tha që pas pikës 1 të rendit të ditës
duhet të ishte zgjedhja e kryetarit të ri të
këshillit Bashkiak

Fjalën e kërkoi këshilltari z. Agostin Marku
i cili tha: Unë problemin e kam me pikën 2
të rendit të ditës. Unë (dhe asnjë këshilltar)
nuk mund të kërkoj interpelancë me drejtoritë.
Marrëdhëniet e këshillit janë me kryetarin
e Bashkisë. Çdo vendimmarrje e këshillit
ngarkon kryetarin e Bashkisë për zbatim.
Është kryetari i Bashkisë që organizon punën
personalisht, edhe me kërkesë, unë i jam
drejtuar kryetarit të Bashkisë dhe nuk i jam
drejtuar drejtorisë. Unë nuk shoh një material

që ka ardhur në mbledhjen e këshillit nga kryetari i Bashkisë. Shoh një material me dy gisht letër, që s'dua t'i hyj në thellësi, që është në të mirën e këshillit sot, që është në të mirën e Bashkisë sot që ta tërheqin atë material. Nuk e kam bërë interpelancën me qëllimin e keq, përkundrazi e kam kërkuar që të rregullohet gjendja e menaxhimit të të ardhurave në Bashkinë e Lezhës, pra e kam me qëllimin e mirë. Kërkoj mirëkuptimin e Bashkisë që ta tërheqin dhe unë do isha dakord ta tërheqin. Të përgatiten mirë për interpelancën. Nuk e kam bërë për të kaluar radhën. Të vijnë në mbledhjen e radhës të përgatitur mirë. Jam i gatshëm dhe në dispozicion t'ju them se ku janë qëllimet e kërkesës sime.

- z. Ndue Luli, për sqarim, citoi Nenin 99 të Rregullores së këshillit në lidhje me interpelancat.
- Erdhën këshilltarët Nevila Like, Greta Marku dhe Joride Mikaj.
- Kryesuesi i mbledhjes i dha fjalën ZV/kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj i cili tha:
- Ermal Pacaj: Në fakt, para se të vija në mbledhje, duke parë materialet dhe duke qenë në dijeni të kërkesës së këshilltarit

Agostin Marku, materiali i përgatitur nuk
më duket shterrues në faktet dhe për këtë
arsye dhe drejtori i Tokësore nuk është këtu
sot, sepse unë i kërkova kabinetit dhe
diskutova me kryetarin që kjo të hiqet nga
rendi i ditës, të paktën për ditën e sotme
Për diskutimin që interpelanca është me kryetarin
e Bashkisë dhe jo me drejtorin e Tokësore —
— me kryetarin e Bashkisë mund të bësh inter-
pelancë për gjithçka tjetër në makro, por jo
në mikro, kështu që patjetër i kërkoj
këshillit që ta heqim nga rendi i ditës sepse
me sa kuptova dhe nga z. Agostin e kemi
dakordësinë. Kërkoj mirëkuptimin tuaj, edhe
pse tashmë e kemi bërë rregjë, për të shtuar
në rendin e ditës 2 projekt vendime ku njëri
është një projekt i rëndësishëm për një infopoint
dhe duke parë se afati i aplikimit është
data 15 gusht dhe këshilli është vështirë të
mblidhet deri në 15 gusht.
Ndue Luli: E hedhim në votim rendin e ditës
duke shtyrë interpelancën dhe duke shtuar dy
projekt vendimet
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
→ Erdhi këshilltarja Vera Pica.
— Ndue Luli: kalojmë te projekt vendimi i parë
në pikën 1 të rendit të ditës "Për heqjen

e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ernest Rakaj".
E kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku dhe z. Anton Ndreu që nuk votuan.
Hasan Muça: Ne i njohëm vullnetin e lirë këshilltarit Ernest Rakaj. Kur bie si këshilltar, bie automatikisht nga çdo lloj pozicioni tjetër që ka patur. Kalojmë te pika tjetër tani, zgjedhja e kryetarit të ri.
Ndue Luli: A jemi dakord që të futet tani se kjo është diçka që nuk është shkruar në rendin e ditës.
Agostin Marku: Vazhdojmë më dallimin. Te pika "Të ndryshme" vazhdohet me zgjedhjen e kryetarit.
Ndue Luli: Dakord.
Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Qershor 2022".
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për një shtesë në VKB nr. 5, dt. 28.01.2020 "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit"".

Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit Gj. Ç dhe T. N. nga fondi i emergjencës".
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2023-2025 (Faza e dytë) të Bashkisë Lezhë".
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e Planit të Shlyerjes së Detyrimeve të Bashkisë Lezhë".
Agostin Marku: këtu flitet pjesa e detyrimeve me dokumente - shuma, pjesa e detyrimeve pa dokumente - shuma. Cilën do miratojmë ne, atë me dokumente apo atë pa dokumente? Ça do bëni me pjesën pa dok. dhe kush janë këto pa dok?
Xhemal Haxhia (Specialist i buxhetit në Bashkinë Lezhë) - Këtu janë përfshirë një pjesë e detyrimeve sipas bilancit që kanë pasur komunat, pa dokumente justifikuese, edhe në relacion është

shpjeguar. Pra kemi kërkuar që të hiqen nga kontabiliteti detyrime që nuk kanë dok. justifikuese. Tani ne kemë ardhur detyrime të papaguara për energjinë elektrike nga viti 2010. Dhe ai që ka bërë bilancin e ish komunave ka parë problemet e veta. Ne jemi të detyruar që çdo gjë të sistemohet në përputhje me ligjin. dyri në sektorët. Ne nuk mund të bëjmë likuidime pa dok. justifikuese.

Pra jemë detyrime për shpronësime para vitit 2015 dhe detyrime për mallra e shërbime.

Agostin Marku: Nqs vjen një detyrim i vitit 2005 dhe nuk është pasqyruar në bilanc, Bashkia duhet të çojë në ndjekje penale personin që ka miratuar bilancin si ekspert.

Problemi është, nuk të kanë dalë 7 vjet, që nga viti 2015 që është krijuar bashkia e madhe, do edhe 2 muaj kohë?

Duket se nuk është marrë kush me këtë punë!

Xhemal Hoxha: Të sqarojmë diçka.

Ne këto detyrime hap pas hapi, ka të paktën nga viti 2019, i kemi në kontabilitet. I kemi mbajtur në kontabilitet. Ne nuk i kemë mbajtur të fshehura. Kjo është e vëndëjishme. E kemi diskutuar dhe me KLSH-në që ishte këtu në mars. Do vijmë këtu me analizë se cilat janë detyrimet që do hiqen nga kontabiliteti, pastaj për

shpronësimet, poashtu për detyrimet mallra e shërbime.
Ndue Luli: E kalojmë në votim
Miratohet nga të gjithë përveç z. Agostin Markun dhe z. Rijels Nicaj që abstenuan.
Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi kanë dalë të pastreha si shkak i dëmtimit të banesave nga rrëshqitja e dherave".
E kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika e pestë shtesë që është projekt-vendim "Për një ndryshim në VKB nr.177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024" dhe përdorim të fondit rezervë" që është për likuidim detyrimesh të prapambetura.
Ka kush diçka? Nuk ka.
Atëherë e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te projekt-vendimi i dytë shtesë dhe i fundit që është "Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë për lidhjen e kontratës së grantit, angazhimin e burimeve financiare në pozicion për bashkëfinancimin, mbulimin e kostove të

TVSH-së dhe mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së info point-it për projektin "Zhvillimi i Turizmit në Lezhë" në kuadër të thirrjes "BE për bashkitë", me referencë aplikimi: EU4M-CfP-2-A13"
E kalojmë në votim mepsë sqarimet i dha në fillim zv/kryetari i Bashkisë.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Atëherë kalojmë te pika "Të ndryshme".
2. Hasan Muça: Mepsë kryetari ka dhënë dorëheqjen dhe duhet të vijojmë me zgjedhjen e kryetarit të ri, unë në emër të grupit socialist propozoj që si kandidat për kryetar të këshillit Bashkiak të jetë z. Ndue Luli.
- Mepërësë nuk ka propozime të tjera me shkrim, atëherë, me dakordësi, u votua për kandidatin e propozuar nga z. Hasan Muça në emër të grupit socialist.
Me 23 vota pro, z. Ndue Luli u zgjodh Kryetar i këshillit të Bashkisë Lezhë.

z. Ndue Luli: Ju falenderoj për besimin që keni. Kam besim që së bashku për kaq kohë të shkurtër sa kemi do ta përmbyllim me sukses mandatin që kemi.
Tani kalojmë te zgjedhja e zv/kryetarit të këshillit Bashkiak.
Kush ka propozime.

z. Hasan Muça: Kryetar, unë në emër të grupit Socialist propozoj znj. Regjina Sokoloj.
- Meqënëse nuk ka propozime të tjera me shkrim, atëherë, me dakordësi, u votua hapur për kandidaten e propozuar nga z. Hasan Muça në emër të grupit socialist.
U votua pro nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Markun që nuk votoi.
z. Ndue Luli: Atëherë vazhdojmë me propozimet për anëtar të Këshillit të Qarkut Lezhë, pas vakancës së krijuar nga dorëheqja e z. Ernest Rakaj.
z. Hasan Muça: Në emër të grupit socialist, propozoj z. Gjin Kola.
- Meqënëse nuk ka propozime të tjera me shkrim, atëherë, me dakordësi u votua hapur për kandidatin e propozuar nga z. Hasan Muça në emër të grupit socialist.
U votua pro nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Markun dhe z. Rigels Nikaj që nuk votuan.
z. Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI